

V E N D I M
Nr.57, datë 4.2.1999

**PËR SHPRONËSIMIM PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I AUTOSTRADËS RROGOZHINË-LUSHNJË, TË KORRIDORIT
VERI-JUG**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7848, datë 25.7.1999 "Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i autostradës Rrogozhinë-Lushnjë, të ndodhura në territorin e rretheve Kavajë dhe Lushnjë, sipas listave emërore përkatëse, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi me sipërfaqe të përgjithshme 323 283 m².

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore të pronarëve të shpronësuar, dhe sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 239 399 950 (dyqindetridhjetenëntë milionë e treqindenëntëdhjetenëntë mijë e nëntëqindpesëdhjetë) lekë.

4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt, për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e shtetit të vitit 1999, në zërin "shpronësime".

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 1999.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike e Transportit, këshilli i rrethit Kavajë, bashkia Rrogozhinë, këshilli i rrethit Lushnjë dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko